

**VENDIM**  
**Nr. 121, datë 2.3.2022**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE  
TË BANIMIT NË NDËRTEA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË DHE  
RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 434 055 000 (katërqind e tridhjetë e katër milionë e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ato individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Tiranë dhe Rrogozhinë, sipas detajimit, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 257 705 000 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e pesë mijë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Rrogozhinë i transferohet fondi në masën 176 350 000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

2. Efekti financiar do të përballohet nga pjesa e financuar nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe u transferohet bashkive Tiranë dhe Rrogozhinë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe njësi banimi në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë e Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**